

# “Planifikoni paratë tuaja, mbilni të ardhmen tuaj”

Punimet fituese të konkursit 2023



## Parathënie



Punimet në vijim janë përzgjedhur si esetë më të mira nga konkursi për ese me temën e Javës Nderkombëtare të Parasë 2023

***"Planifikoni paratë tuaja mbillni të ardhmen tuaj".***

Esetë janë punuar nga nxënësit e klasave X-XII, të shkollave të mesme të Kosovës dhe shtjellojnë pikëpamjet e tyre mbi rolin dhe rëndësinë e menaxhimit të financave personale, ndikimin e sjelljes individuale financiare, jo vetëm për të ardhmen financiare, por edhe për mjedisin dhe shoqërinë. Qëndrimin e të rinjve lidhur me nevojat për edukim financiar, si dhe qëllimet që përpiqen t'i realizojnë përmes kursimeve.

Esetë në vazhdim janë origjinale, kreative, reale apo magjinare, dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë jetën private të pjesëmarrësve.



## **Kreshnik Beqiri**, SHFMU “Eqrem Çabej” Vushtrri, klasa e XII-të

Kursim (emër) - Metodë e organizimit dhe drejtimit të ekonomisë, që synon të rritë të ardhurat e të mirat materiale, duke i përdorur ato me kujdes e me rregull, pa teprime e pa i çuar dëm.

Si fëmijë, kurrë nuk u kam vënë veshin fjalëve të babait tim, ekonomist, që gjithmonë më ka kritikuar për qasjen time ndaj parave personale duke më ofruar këshilla tejet të vyera, prapë pa adresë mbi kursimin si metodë efikase për të siguruar një jetesë të qetë dhe stabile. Para dy vitesh, kur si një gjashtëmbëdhjetë vjecar fillova punën time të parë kuptova se këshillat e tij në fëmijëri ishin e vërteta që nuk e kisha vërejtur, kur po shpenzoja pa kontroll paratë që nuk i fitoja me djersën time. Gjatë asaj pune të parë praktike që nuk kërkonte shumë mund, fillova të siguroj edhe të hyrat e para personale, të cilat vazhdoja t'i shpenzoj pa kontroll. Shpenzoja gjithnjë shumë për tu provuar të tjerëve se unë nuk shpenzoja vetëm se nuk fitoja vet, por sepse nuk besoja tek kursimi si metodë ekonomike, duke e parë si një që largon para nga tregu dhe i bën ato të paqasshme.


Atëherë nuk e dija se duke duke u nisur me ato bindje po i provoja vetes se kursimi është zgjidhja për menaxhim e parave personale dhe se pas një kohe do të mendoja si ta përqafoj këtë metodë si timen sa më shumë të jetë e mundur. Në fillim, unë nuk kisha me çka të vazhdoja muajin pas gjysmës së tij të parë. Pastaj, nuk arrija t'i siguroja vetes një palë të mbathura që më pëlqenin, nuk mund t'ju blija dhuratata të dashurëve të mi në raste speciale dhe shpeshherë më duhej të thellohesha në obligime ndaj të tjerëve për tua kthyer muajin tjetër. Këto shpenzime më vendosnin në pozita jo të mira dhe nganjëherë ndjehesha shumë keq për mënyrën se si jeta ime shkonte— gjithmonë kisha borxh ndaj dikujt! Ndaj, vendosa të ndryshoj qasjen time.

Fillova të kurseja paratë e para dhe qysh në fillim pashë rezultatet pozitive të vetes sime të re. Ndjeja më pak stres, isha bërë më i dashur e shume më pak koprrac. Isha baraz me të gjithë dhe nuk ndjeja aspak stres. Tani, dy vite pas, kursimi i parave është bërë pjesë e pandashme e sistemit tim jetësor. Përpiqem të kursej në çdo gjë që është e mundur dhe e kam vërjetur se kjo formë e menaxhimit të parave është një kontribut edhe për shoqërinë. Nisur nga niveli lokal unë nuk marrë një taksë dhe vazhdoj rrugën në këmbë, për të kursyer para e për të ruajtur ambientin. Unë ndali dritat që nuk nevojiten kudo që i shoh dhe gjatë dimrit në vend se të nxehem me rrymë elektrike unë mbulohem me një batanije më shumë duke kursyer energji e kështu duke ruajtur e kursyer edhe ambientin. Mendoj se disa duhet ta kuptojnë se të ruash nuk do të thotë të izolosh çdo të hyrë.

Përkundrazi, të kursyerit të ofron mundësi që të çlirosh kreativitetin tënd dhe të investosh ato para në çkado që ti e konsideron strategjike apo humane. Unë, me kursimet që kam arritur të mbledh, dua të ndihmoj babain tim për të paguar shpenzimet e Universitetit e pse jo edhe të kontribuoj pak nga puna për të filluar një biznes të ri. E di se, me kursimet që kam, studimet nuk do të jenë problem për mua dhe kjo më bën shumë të qetë. Por, këtë nuk mund ta them për nxënës të tjerë. Ndaj, kur të arrij një moshë më të shtyer, mezi pres që kursimet e mija t'i shfrytëzoj për të mbuluar studimet e sado të rinjëve që mundem për sado gjatë. Nuk mund ta mbyll këtë ese më mirë sesa me vet titullin e saj. Unë ndava eksperiencën time për të treguar shumë personalisht se sa i rëndësishm është kursimi i paravë për një jetë stabile, progresive për shoqërinë si tërësi e lehtësuese për një pleqëri të qetë.

**“Planifikoni paratë tuaja, mbillni të ardhmën tuaj!”**





**Latif Qorri**, SHFML "Gjergj Kastrioti", Drenas klasa e X-të

Ne rritemi duke qenë të rrethuar me shumë gjësende të cilat kanë një vlerë të caktuar të parasë, por meqë si fëmijë dhe adoleshentë nuk paguajmë vetë për ato, shpeshëherë nuk ia dijmë rëndësinë. Duke u rritë në moshë dhe dikur duke marrë nga një shumë të caktuar të parave nga prindërit, të cilën na e japin ta shfrytëzojmë gjatë ditës apo javës për shujta ushqimore në shkollë, fillojmë hapat e parë drejt menaxhimit të parave apo planit të shpenzimit të buxhetit që kemi.

Megjithatë, si nxënës i klasës së dhjetë, në të cilën jam aktualisht, është e lehtë të anashkalosh rëndësinë e menaxhimit të parave, duke pasë shumë mundësi për shpenzimin e tyre nga do që lëviz. Por në realitet, nëse duam të arrijmë objektivat tona dhe të bëjmë jetën që duam, të gjithë duhet të mësojmë se si t'i trajtojmë paratë tona.

Pavarësisht nga moshë apo niveli i të ardhurave menaxhimi i financave personale është thelbësor për të gjithë. E ky menaxhim përfshin vendosjen e qëllimeve financiare, si zhvillimin e një buxheti, kursimin e parave, investimin me zgjuarsi dhe menaxhimin e borxhit. Duke kuptuar bazat e financave personale, ne mund të marrim vendime të balancuara për paratë tona dhe të fillojmë të ndërtojmë një themel të fortë financiar për të ardhmen tonë. Pra, është e rëndësishme të kemi një plan të menaxhimit të parave sepse duke vepruar kështu, ne mund të arrijmë qëllimet tona financiare, të tilla si vetëfinancim i studimeve brenda apo jashtë vendit, fillimi i një biznesi, udhëtimet turistike, blejra e një veture, shtëpie apo kursime për kohën e pensionit. Derisa, pa aftësi të mira të menaxhimit të parave, ne rrezikojmë të futemi në borxhe, kur të punësohemi të jetojmë me para nga paga në page si dhe të humbasim mundësitë e zhvillimit tutje. E sjellja financiare individuale ka një ndikim të rëndësishëm jo vetëm në të ardhmen tonë financiare, por edhe në mjedis dhe shoqëri.

Për shembull, nëse përfshihemi në konsum të tepruar të veshmbathjeve, ushqimeve të konservuara, ushqimeve me paktetime plastike dhe të tjera shpenzime të kota, ne kontribuojmë në degradimin e mjedisit. Nga ana tjetër, nëse adoptojmë zakone të përgjegjshme të konsumit dhe kursimit, ne mund të kontribuojmë në zhvillimin e qëndrueshëm. Duke i menaxhuar mirë paratë tona, ne mund të kemi një ndikim pozitiv në botën përreth nesh.

Ne të rinjtë, sigurisht kemi nevojë për edukim financiar për të zhvilluar aftësi të mira të menaxhimit të parave. Derisa konsideroj se edukimit financiar duhet kushtuar orë mësimore duke filluar që nga shkolla fillore e deri në universitet. Duke mësuar për menaxhimin e financave personale herët, ne mund të zhvillojmë zakone të mira financiare që do të na shërbejnë mirë gjatë gjithë jetës sonë.


Duke vepruar kështu, ne mund të arrijmë qëllimet tona financiare dhe të sigurojmë një të ardhme të ndritshme financiare për veten tonë. Si nxënës, personalisht kam disa dëshira dhe synime që mundohem t'i realizoj me kursimet e mia. Për shembull, dua të kursej për studime në universitete prestigjioze, të filloj një biznes startup, të udhëtoj në pjesë të ndryshme të botës dhe kur të arrij një moshë rreth të tridhjetave përfundimisht të blej një apartament apo shtëpi. Pra, unë tashmë kursej një pjesë të parave që marr nga familja ime çdo muaj dhe i ruaj ato në një llogari kursimi. Derisa duke zhvilluar zakone të tilla financiare tani dhe duke kursyer paratë e mia me mençuri, besoj se mund t'i arrij këto synime dhe të siguroj një të ardhme premtuese për veten time.

Si përfundim, menaxhimi i parave është një aftësi kritike e jetës që ne të gjithë duhet ta mësojmë, pavarësisht nga moshë apo situata në të cilën gjendemi. Derisa, si nxënës, ne kemi përgjegjësinë të edukojmë veten rreth menaxhimit të financave personale dhe të adoptojmë sjellje të përgjegjshme financiare. Duke vepruar kështu, ne mund të arrijmë qëllimet tona financiare dhe të kontribuojmë për një të ardhme më të mirë për veten, komunitetin tonë dhe mjedisin.

Duke mos harruar dhe duke i rukujtuar vetës kohë pas kohe moton shumë domethënëse

**"Planifikoni paratë tuaja, mbillni të ardhmen tuaj!"**





**Vlona Selimi**, Gjimnazi "Kuvendi i Lezhës", klasa X-të, Viti

Paraja është një mjet që përdoret çdo ditë. Gjatë historisë paraja ka marrë forma të ndryshme, por çdo herë ka qenë pjesë e rëndësishme në shoqëri. Roli i saj është ajo çfarë e bën thelbësore në jetën tonë. Siç kemi mësuar në lëndën e ekonomisë paraja shërben si: mjet këmbimi, njësi matëse dhe depozituese vlerash. Me një fjalë ne i përdorim paratë për të marrë çka na nevojitet që të jetojmë dhe arrijmë synimet tona.

Por ajo nuk është diçka që mund të fitohet lehtë dhe në sasinë e dëshiruar çdo herë që na duhet. Për këtë arsye menaxhimi dhe planifikimi i aktiviteteve personale financiare është një proces i rëndësishëm.

Me financa personale kuptojmë planifikimin dhe menaxhimin e të ardhurave, shpenzimeve, kursimeve etj. Ndryshe mund të themi që financat personale janë menaxhimi i të ardhurave sipas situatës tonë financiare dhe krijimi i buxhetit për shpenzimin dhe kursimin e parave tona. Pra, kursimi është pjesë e menaxhimit të financave tona personale. Sunday Adelaja ka thënë: "Prosperiteti financiar është i pamundur pa planifikim të vazhdueshëm të parave."

Kjo vlen edhe për ne adoleshentet. Duke menaxhuar të ardhurat tona ne mund të lëmë anash një shumë nga paratë tona për të formuar një buxhet të kursimeve. Këtë e shohim shpesh tek prindërit tanë, por këtë mund ta praktikojmë edhe ne.

Si mund ta bëjmë këtë? Edhe pse shumica nga ne nuk kemi të ardhura pasi që nuk punojmë, menaxhimin e financave e bëjmë me paratë e xhepit të cilat i marrim nga prindërit tanë.

Ndajmë një pjesë nga paratë e xhepit për nevojat tona dhe pjesën tjetër e kursojmë. Dëshira për të blerë dhe provuar gjëra të reja është shumë e madhe, një nga shkaqet duke qenë qasja e pakufizuar në internet. Interneti përmban gjëra të ndryshme që na e tërheqin syrin dhe na ngjallin dëshirën për ti pasur. Por mungesa e parave shfaqet si pengesë për blerjen e këtyre gjërave.

Një mënyrë nëpërmjet së cilës ne mundemi sadopak ta zgjidhim këtë problem është menaxhimi i financave personale.

Pse duhet të formojmë një buxhet?

Një ndër arsyet kryesore për formimin e një buxheti zakonisht është për të arritur deri te një synim i yni. Ne planifikojmë një mënyrë kursimi në mënyrë që të arrijmë synimin tonë. Synimet ndryshojnë nga një njeri te tjetri pasi të gjithë kemi shije dhe preferenca të ndryshme.

Ndokush dëshiron që me paratë e kursyera ta blejë një biçikletë, dikush tjetër një laptop.

Kështu kostoja oportune është e ndryshme për të gjithë.

Megjithëse arritja deri tek qëllimet tona është një ndër përfitimet që vijnë nga planifikimi i financave personale, nuk është përfitimi i vetëm. Në vazhdim do flas për disa nga benefitet e menaxhimit të financave personale.

-Largojmë shprehinë e mbishpenzimit. Ka shumë njerëz që nuk mund të heqin dorë nga blerja e gjërave të panevojshme dhe blerjet impulsive. Shpesh kur shohim diçka që na pëlqen dhe ka çmim të lirë vendosim që ta blejmë duke menduar se nuk do sjell ndonjë ndryshim në buxhetin tonë. Por në të vërtetë këto blerje janë ndër shkaqet kryesore të dëmtimit të financave tona. Pas këtyre blerjeve ne mbesim me pak para dhe fillojmë të ndihemi të stresuar nga ky fakt. *"Kujdes nga shpenzimet e vogla. Një rrjedhje e vogël mund ta fundos një anije të madhe."* - Benjamin Franklin

Duke kursyer ne heqim dorë nga këto mbishpenzime të cilat nuk sjellin gjë tjetër përveç shqetësimeve. Duhet të motivohemi duke përkujtuar qëllimin tonë i cili është më i rëndësishëm se çdo pakënaqësi momentale.

-Zvogëlojmë stresin. Jo rrallëherë gjejmë veten duke u shqetësuar për shkak të mungesës së parave. Nëse një mik ka ditëlindjen dhe ne dëshirojmë t'ia blejmë një dhuratë të mirë, por nuk kemi para të mjaftueshme, kjo na sjell stres. Një gjë e tillë nuk ndodh kur kemi një buxhet.

Kohën që do e kishim kaluar duke u shqetësuar për diçka të tillë, mund ta shfrytëzojmë për diçka prej të cilës mund të përfitojmë.

-Fitojmë shprehi të mira dhe i afrohem realizimit të ëndrrave tona. Gjatë menaxhimit të financave ne formojmë shprehi të mira dhe të rëndësishme për jetë. Rol kyç për kursim është konsistenca. Sipas John Maxwell disiplinat e vogla të përsëriturave konsistence çdo ditë, qojnë në arritje të mëdha të fituara ngadalë me kalimin e kohës. Suksesi nuk është diçka që mund të arrihet brenda një nate dhe pa mund. Këtë mësim e marrim duke kursyer. Përveç se jemi konsistent, fitojmë dhe ndjenjën e përgjegjësisë. Për ne adoleshentet është e rëndësishme të jemi përgjegjës për vendimet e tona. Duke marrë përgjegjësi ne ndihemi më të pavarur dhe matur dhe na bën të ndihemi që jemi në kontroll të jetës sonë. Duke qenë më të pavarur nga prindërit tanë ndihemi më të lirë dhe jemi në gjendje të marrim vendime më të mira për jetën tonë.

- Ndihe mi mirë. Duke vënë objektiva të vogla dhe duke punuar deri tek përmbushja e tyre na jep një ndjenjë kënaqësie dhe përmbushjeje. Kur jam në gjendje të heq dorë nga një dëshirë e imja për të arritur deri tek qëllimi, ndjehem më e pjekur dhe e lumtur dhe njëkohësisht motivohem që të punoj deri në fund të qëllimit. Gjithashtu në këtë mënyrë ne kuptojmë që jemi të aftë të realizojmë çdo gjë rreth së cilës kemi vendosur të punojmë. Zhvillohem si individë duke mësuar pas provave dhe gabimeve. Pa marr parasysh se vendimi është i vogël apo i madh, ne mësojmë nga veprimet tona të mëparshme për të marrë vendime sa më të mira në të ardhmen. Duke ditur se kemi dhënë maksimumin tonë për diçka ne ndihemi të kënaqur pavarësisht rezultatit. Na ofron siguri dhe na përgatit për të ardhmen. Të pasurit e një buxheti na ofron siguri. Në rast se na shfaqet ndonjë situatë urgjente ose ndonjë mundësi e re për ne, financat nuk do paraqesin problem. Buxheti na mundëson të pranojmë mundësi të reja dhe të kalojmë situata urgjente, gjëra që nuk ishin të mundura pa pasur buxhetin tonë.

Këtë e përshkruan shumë mirë Aristoteli: "Paratë janë një garanci që ne mund të kemi atë që duam në të ardhmen.

Edhe pse ne nuk kemi nevojë për asgjë për momentin, ajo siguron mundësinë për të kënaqur një dëshirë të re kur ajo lind." -Menaxhimi i financave është i pashmangshëm në të ardhmen tonë. Duke filluar ta praktikojmë atë që në moshë të re do na e bëj shumë më të lehtë dhe argëtuese në të ardhmen pasi që tashmë do kemi eksperiencë.

Edukimi rreth menaxhimit financiar personal është esencial.

Menaxhimi financiar nuk është diçka për të cilën flitet shpesh dhe mjaftueshëm nëpër institucione arsimore. Në një shoqëri ku të rinjtë mendojnë vetëm për të tashmen dhe të ardhmen e afërt pa menduar më larg, planifikimi i buxhetit është temë për të cilën duhet të dëgjojmë dhe vetëdijesohe mi më shumë. Synimi im është të studioj jashtë vendit. Studimi jashtë vendit është një ëndërr që e kam pasur për një kohë të gjatë dhe për të cilën dua të jap maksimumin tim për ta arritur. Një mënyrë që unë punoj drejt këtij synimi është kursimi. Edhe pse me paratë që kursej unë, nuk është e mundur ti mbuloj të gjitha shpenzimet, unë mendoj ti shfrytëzoj ato për një pjesë të shpenzimeve. Pra, unë duke kursyer për një të ardhme më të mirë, njëkohësisht përmirësoj vetet e mia dhe i afrohem versionit të vetes që dua të jem. Kjo është një gjë shumë e rëndësishme për mua.

Duke menaxhuar financat ne mund të ndikojmë pozitivisht edhe në shoqëri. Kur kemi një shumë më të madhe parash ne mund të bëjmë zgjedhje që nuk e dëmtojnë ambientin tonë, dhe nëse kemi ruajtur një shumë të mjaftueshme për investim ne mund të ndihmojmë edhe bizneset e vogla.

Një efekt anësor i kursimit mund të shfaqet në rast të inflacionit. Kur ndodh inflacioni, vlera e kursimeve tona, dhe e parasë në përgjithësi, bie. Në këtë situatë ne pësojmë humbje. Megjithatë, kjo nuk është arsye për të shtyrë menaxhimin e të ardhurave.

Planifikoni paratë tuaja, mbillni të ardhmen tuaj.

Paraja është një mjet që duhet të jemi në gjendje ta përdorim për avantazhin tonë pasi që është një mjet i krijuar për të na shërbyer. Duke planifikuar se si do e përdorim atë ne i shfrytëzojmë paratë në nivelin maksimal dhe nuk e lëmë të na dëmtojë neve. Kursimet janë një mënyrë e mrekullueshme për të punuar për një të ardhme sa më të mirë. Duke menaxhuar financat personale ne përfitojmë jo vetëm në aspektin financiar, por edhe në jetën e përditshme. Sa më herët fillojmë t'i menaxhojmë të ardhurat, aq më të kënaqur do jemi me rezultatet tona.

**"Paraja është zotëri i tmerrshëm por një shërbëtor i shkëlqyer."**- P.T. Barnum





## Erin Laçi, " Gjin Gazulli", Kl. XI-të Prishtinë

Në këtë shekull gjithçka sillet rreth parasë. Madje thuhet se paraja e rrotullon botën.

Po pate para ke vlerë, në të kundërtën sikur nuk ekziston. Vlera njerëzore, dija, diplomat, gradat, ndjenjat, dashuria, mirësia, mëshira... duket se asgjë nuk ka vlerë më të madhe se paraja. Këtë e kam kuptuar, ndonëse jam në moshë të re. Fatkeqësisht në shkollë nuk na mësojnë si të bëjmë para, por gjëra që ndoshta nuk do të na hyjnë në punë asnjëherë.

Rolin dhe rëndësinë e parave e kam kuptuar në familje që i vogël, kur për çdo gjë që mungonte, thuhej se ishte faji i parave. Prandaj nisa të ruaj çdo cent që më jepte dikush për ditëlindje a festa, me dëshirën që t'i plotësoja krejt ato që mungonin. Por, në atë mënyrë përmbushja vetëm dëshirën e prindërve për të kursyer siç thoshin "për të ardhmen", pasi shuma që grumbullova për vite me radhë ishte e vogël dhe nuk garantonte pothuajse asgjë, as për të tashmen e as për të ardhmen. Ishte zhgënjyese që për shumë vjet kisha arritur të mblidhja një shumë të vogël parash, por kjo pati efekt tek unë, sidomos në edukimin për kursim.

Në moshën time nuk kanë para të gjithë. Disa, që janë me më shumë fat, kanë dhe i ekspozojnë aq shumë, pa menduar se ne të tjerët mund të lakmojmë. Rrjetet sociale vlojnë nga njerëz që në ndonjë mënyrë kanë bërë para dhe mendojnë se me to mund të blejnë gjithçka. "Lumturia nuk blihet me para", më thotë shpesh nëna ime. Sidoqoftë, nuk e kam pasur mundësinë ende ta vërtetoj këtë.

Për të kursyer e kuptova që duhet të punoj e të fitoj pasi vetëm dhuratat ishin shumë pak. Në shkollë të mesme vendosa të gjej punë me orar të pjesshëm. Për fat, së fundmi ndjehet mungesë punëtorësh, ndaj gjeta një punë të lehtë. Megjithëse nuk fitoj shumë, me të ardhurat e mia tani mbuloj shpenzimet ditore dhe njëkohësisht ndaj ca para mënjanë. Kam hapur edhe llogarinë time bankare, ku herë pas here deponoj ca para, duke menduar studimet dhe të ardhmen.

Shuma që arrij të ruaj është e vogël. Pavarësisht kësaj, asnjëherë nuk pushoj së ëndërruari se një ditë do të bëj para, me pak fat natyrisht. Por edhe duke kursyer shumë. Tani e kam vërtetuar se pika-pika mbushet pusi ndaj nuk do të ndaloj së kursyeri.

Do doja shumë që me kursimet e mia të arrij të blej një motoçikletë sapo të mbush 18 vjet. Kjo është ëndrra ime. Ndoshta me kalimin e viteve dëshirat dhe synimet do të ndryshojnë, por aktualisht nuk bëj shumë plane për të ardhmen. Fokusohem vetëm në të tashmen, në mësim, përtej plan programit mësimor, dhe në punë. Mbase studimet do të më "gëlltisnin" tërë kursimet e gjërat tjera do i shmang, ose do i shtyj për më vonë. Apo ndoshta do të krijoj një biznes.

"Nuk është i pasur ai që ka shumë, por ai që jep shumë. Më jep mua pak para", pata dëgjuar dikur një lypës në rrugë, tek i drejtohej shoferit të një makine luksoze që ishte ndalur në semafor.

Ajo fjali e thënë aq thjesht nga ai djalë që ishte pak a shumë në moshën time, mu ngulit thellë në kujtesë. Kisha lexuar se çdo ndihmë që ia jep dikujt, dikur do të gjejë rrugën e të kthehet tek ti.

Njeriu ka obligim të ndihmojë tjetrin në rast nevojë. Sepse secili mund të kemi nevojë ndonjëherë. Për këtë arsye, sa herë shoh një dorë të shtrirë në rrugë, i jap para, që t'ia kthej sadopak buzëqeshjen. Në këtë mënyrë, unë ndihmoj dikë pa u varfëruar vetë, njëkohësisht shpreh falënderim për krejt çfarë kam. Shikimi mirënjohës i atyre që jeta i ka sprovuar në atë mënyrë, është shtysë që të vazhdoj tutje, të sillem si një i rritur i përgjegjshëm.

Gjithsesi, përveç përmbushjes së nevojave dhe dëshirave personale, synimi im është shumë më i madh; dua të bëhem njeri me vlera të larta, të ndihmoj aq sa mundem njerëzit që kanë nevojë dhe të shërbej si model për të tjerët. Jeta është shumë e shkurtër dhe një ditë krejt çfarë do të ngelet nga ne, do të jenë veprat tona. Prandaj duhet të kujdesemi të bëjmë vepra të mira.

Një njeri mund të jetë i mirë edhe nëse nuk ka para. Le të bëhemi solidarë me njëri-tjetrin, sepse sot mund të ketë nevojë dikush, e nesër ndoshta unë, ti apo ai tjetri.

Paratë janë mjet që garantojnë jetesë më të mirë, por nuk besoj që duhet të bëhemi robër të tyre. Edhe me pak para mund të bëhemi të lumtur.

Bota aktualisht sillet rreth parave, por mendoj që humanizmi do të triumfojë një ditë.





**Granit Kalaja**, Gjumnazi "Xhevdet Doda", Kl X-të, Prishtinë

Me nxitim po vija nga shkolla, isha bërë vonë për tek biblioteka. E kishim planifikuar që prej kohësh të tre se do të ishim në bibliotekë nga ora pesëmbëdhjetë. E hudha çantën shpejt, mora një shishe me ujë që t'a kem me vete, e mbylla derën dhe u nisa prapë me nxitim për të zënë autobusin në kohë. Mendoja me vete, pasi hyra në autobus se ne njerëzit planifikojmë për çdo gjë edhe pse i marrim masat e duhura, e parashikojmë ecurinë a mënyrën e zhvillimit të një pune a veprimtarie, vëllimin dhe afatet e saj prapë prapë na ndodh që shumëherë mos të arrijmë me kohë, mos të na del planifikimi ashtu siç e kemi menduar. Një trafik i dendur përpara po na priste dhe ngasësi i autobusit tani vetëmse e ndaloi tërësisht shpejtësinë.

Më në fund, mbërrita në bibliotekë. Dy shokët e mi ishin dhe ulur dhe po lexonin, unë nuk i pengova. Fillova të kërkoj për një libër që ma kishte rekomanduar profesoresha e gjuhës shqipe "Psikologjia e parasë" nga Morgan Housel, mendonte se duhej t'a lexoja atë libër, ndoshta kishte të drejtë. E gjeta librin, ishte afër librit "Hyrje në Psikoanalizë" të Zigmund Frojd. E mora librin.

E lexova librin të tërin, dyqindë e shtatëdhjetë e shtatë faqe me mësim të shumta mbi mënyrën se si të kemi sukses me paratë.

Të kesh sukses me paratë nuk ka të bëjë patjetër me atë çfarë di por mënyrën se si sillesh. Dhe sjellja është e vështirë të mësohet edhe nga njerëzit më të zgjuar.

Planifikimi dhe menaxhimi i duhur i financave ndikon detyrimisht për një të ardhme më të mirë, për mirqenie më të mirë. Planifikimin financiar duhet t'a bënë secili individ veçanërisht prindërit tanë të cilët janë në "përkujdesje" të buxhetit të familjes. Planifikim financiar do të thotë të parashtroni pyetjet për të tashmen dhe të ardhmen tuaj, dëshirat dhe qëllimet që keni për synim. Duhet të mendoni rreth asaj se si dëshironi t'a bëni jetën tuaj, siç janë blerja e veturës shtëpisë apo banesës, avancimi në arsimim etj.

Vlerësoni opsionet që keni në dispozicion Parashtroni pyetje rreth asaj se çka duhet të bëni pastaj merrni vendimin. Përgjigjet e atyre pyetjeve janë pjesë e planifikimit.

Planifikimi mund të jetë afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë. Ideali është planifikimi deri në moshën e pensionit.

Për t'i realizuar dëshirat, synimet, qëllimet që duhet t'i vendosni duhet të planifikoni financat tuaja. Planifikimi financiar personal përfshinë buxhetin tuaj ( mjetet në dispozicion ), kursimet, shpenzimet me kalimin e kohës.

Shumë njerëz mendojnë se planifikimi i financave është një proces shumë i ndërlikuar që i pengon ata të bëjnë gjërat që kanë dëshirë. Nëse do të jetonit me një shumë të kufizuar parash normalisht se shumë aktivitete duhet të sakrifikonit. Me planifikim financiar ju: do të keni kontroll të madh mbi financat tuaja, do të shmangni shpenzimin e tepërt dhe të panevojshëm, do të shmangnit borxhet dhe varësinë nga njerëzit e tjerë, nuk do të keni shqetësime financiare sepse ju e keni planifikuar të ardhmen, i keni parashikuar shpenzimet, i realizoni qëllimet tuaja, do të jeni efikas në fitimin, përdorimin, ruajtjen e mjeteve tuaja financiare.

Me një plan të mirë financiar planifikoni nevojat tuaja të ardhshme dhe mjetet të cilat i përdorni. Gjithashtu do të jeni edhe më të qetë duke e ditur se gjendja juaj financiare është nën kontroll.

Gjatë planifikimit financiar duhet të: vlerësoni gjendjen aktuale financiare, të vendosni qëllimet tuaja, të përcaktoni aktivitetet që do të ndërmerri, bëni përpunimin e planit financiar, zbatimin e planit dhe në fund monitorimin dhe rishikimin e realizimit të planit.

Gjatë jetës njeriu kalon në faza të ndryshme të jetës kështu që në faza të ndryshme të jetës kemi priorite, përgjegjësi dhe qëllime të ndryshme financiare. Në çdo rast patjetër duhet t'i përshtatemi prioriteve tona financiare për t'i plotësuar nevojat e ndryshme të fazave të ndryshme të jetës. Por, për të arritur qëllimet financiare duhet të fitoni dhe kurseni para të mjaftueshme.



Qëllimet financiare të mia për momentin janë më shumë afatshkurte për shembull: për të blerë libra, për të vizituar ndonjë vend, për të dalur me shokët etj. Këto qëllime financiare afatshkurte gjithsesi se do të ndryshohen me kalimin e moshës. Por, unë gjithmonë mundohem të jem kritikë në shpenzime që bëj.

Autori në librin që sapo e lexova thotë:

**"Një plan është i dobishëm vetëm nëse arrinë t'i mbijetojë realitetit. Një e ardhme me të panjohura është realiteti i të gjithëve".**

Po më mbyllen sytë, është koha për të fjetur .

Edhe sot po fle, në bibliotekë.







**Shkurte Elshani**, , Gjimnazi "17 Shkurti", Kl. XI-të, Obiliq

Si nxënës/e i/e shkollës së mesme, mund të jetë e lehtë të besosh se menaxhimi i parave është diçka e rezervuar për të rriturit. Megjithatë, e vërteta është se menaxhimi i parave është një aftësi që mund të sjellë dobi në çdo moshë. Nga menaxhimi i pagesave deri te marrja e vendimeve për universitet dhe më gjerë, zakonet financiare do të luajnë një rol të rëndësishëm në të ardhmen tuaj. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme të filloni të mendoni për financat tuaja tani dhe të mendoni se si mund të përfitoni sa më shumë nga paratë që keni.

Një nga aspektet më kritike të menaxhimit të parave është menaxhimi i financave personale. Kjo përfshin krijimin e një buxheti, kursimin për të ardhmen dhe marrjen e vendimeve të zgjuara për shpenzimet tona. Sipas National Endowment for Financial Education (NEFE), edukimi financiar është thelbësor për individët që të arrijnë stabilitet financiar dhe sukses. NEFE citon gjithashtu statistika që tregojnë se individët që marrin arsim financiar kanë më shumë gjasa të marrin vendime më të mira financiare dhe të arrijnë qëllimet e tyre financiare. Është e lehtë të mendojmë se sjellja financiare individuale ndikon vetëm në të ardhmen tonë financiare. Megjithatë, zakonet tona të shpenzimeve kanë gjithashtu një ndikim në mjedisin dhe shoqërinë në tërësi. Për shembull, zgjedhja për të blerë produkte nga kompani të qëndrueshme dhe etike mund të ndihmojë në mbështetjen e përpjekjeve për reduktimin e mbetjeve dhe mbrojtjen e burimeve natyrore. Duke qenë të vetëdijshëm se si i shpenzojmë paratë tona, ne mund të kemi një ndikim pozitiv në botën përreth nesh.

Fatkeqësisht, edukimi financiar nuk ka gjithmonë prioritet në shkolla. Si rezultat, shumë të rinj mund të mos kenë njohuritë dhe aftësitë që u nevojiten për të menaxhuar paratë e tyre në mënyrë efektive. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ne nuk mund të ndërmarrim hapa për të edukuar veten. Një studim nga Autoriteti Rregullator i Industrisë Financiare (FINRA) zbuloi se shumë të rinj në moshë madhore u mungojnë njohuritë bazë financiare, gjë që mund të pengojë aftësinë e tyre për të marrë vendime financiare. Studimi zbuloi gjithashtu se individët që kanë ndjekur një kurs të financave personale kanë nivele më të larta të edukimit financiar dhe kanë më shumë gjasa të kursejnë për pension.

Duke lexuar libra dhe artikuj, duke marrë pjesë në seminare dhe duke kërkuar këshilla nga burime të besueshme, ne mund të kuptojmë më mirë financat personale dhe të marrim kontrollin e të ardhmes sonë financiare. Duke identifikuar atë që duam të arrijmë, ne mund të krijojmë një plan se si të arrijmë atje. Për shembull, mund të kursejmë para për kolegji, udhëtime ose një pagesë paraprake për një shtëpi. Duke vendosur qëllime specifike dhe duke ndjekur progresin tuaj, mund të qëndroni të motivuar dhe të merrni vendime të informuara se si t'i përdorni paratë tuaja. Pra, menaxhimi i parave është një aftësi që mund të na sjellë dobi në çdo moshë. Duke i dhënë përparësi menaxhimit të financave personale, duke qenë të ndërgjegjshëm për ndikimin tonë në mjedis dhe shoqëri, dhe duke kërkuar edukim financiar, ne mund të marrim kontrollin e të ardhmes sonë financiare. Pavarësisht nëse kursejmë për universitetin, udhëtojmë nëpër botë ose blejmë shtëpinë tonë të parë, zakonet tona financiare do të luajnë një rol kritik në arritjen e qëllimeve tona. Pra, planifikoni paratë tuaja, mbillni të ardhmen tuaj dhe shikoni ëndrrat tuaja të bëhen realitet.

Edukimi financiar dhe menaxhimi i parave janë aftësi kritike për njerëzit e të gjitha moshave, por veçanërisht për të rinjtë që sapo kanë filluar të mësojnë për financat personale. Në vende të ndryshme, ka iniciativa dhe programe të ndryshme që synojnë edukimin e të rinjve mbi rëndësinë e menaxhimit të parave. Në Shtetet e Bashkuara, për shembull, edukimi financiar është bërë një pjesë gjithnjë e më e rëndësishme e kurrikulës së shkollës së mesme. Sipas një studimi të Këshillit për Edukimin Ekonomik, 22 shtete në SHBA kërkojnë që nxënësit e shkollave të mesme të ndjekin një kurs të financave personale në mënyrë që të diplomojnë. Përveç kësaj, shumë shkolla ofrojnë programe dhe seminare të edukimit financiar për të ndihmuar studentët të mësojnë rreth buxhetimit, kursimit dhe investimit.

Në Evropë, Bashkimi Evropian ka nisur disa nisma për të promovuar edukimin financiar tek të rinjtë. Programi i BE-së për Garancitë për Rininë synon t'i ofrojë çdo të riu një ofertë cilësore punësimi, arsimimi të vazhdueshëm, stazhi ose praktike brenda katër muajve nga largimi i arsimit formal ose papunësisë. Përveç kësaj, BE-ja ka krijuar një rrjet kombëtarë të edukimit financiar për të ndihmuar në promovimin e edukimit financiar në të gjithë rajonin

Në Azi, ka pasur një fokus në rritje në edukimin financiar vitet e fundit. Vende të tilla si Japonia dhe Singapori kanë prezantuar programe të edukimit financiar në shkolla, ndërsa në Indi, qeveria ka nisur disa iniciativa që synojnë promovimin e përfshirjes financiare dhe shkrim-leximit midis të rinjve të vendit.

Në përgjithësi, ndërsa niveli i edukimit financiar dhe i ndërgjegjësimit mund të ndryshojë nga vendi në vend, ekziston një njohje në rritje e rëndësisë së menaxhimit të parave dhe financave personale midis të rinjve anembanë botës. Ndërsa më shumë vende i japin përparësi edukimit financiar dhe promovojnë edukimin financiar midis qytetarëve të tyre, ne mund të presim të shohim më shumë të rinj të pajisur me njohuritë dhe aftësitë që u nevojiten për të marrë vendime të informuara financiare dhe për të arritur qëllimet e tyre financiare.

Si përmbledhje, menaxhimi i parave dhe financat personale janë aftësi thelbësore për individët e të gjitha moshave, por veçanërisht për të rinjtë. Zakonet e mira financiare dhe vendimmarrja e informuar mund të ndihmojnë në arritjen e stabilitetit dhe sigurisë financiare, duke pasur gjithashtu një ndikim më të gjerë në shoqëri dhe mjedis. Ndërsa edukimi financiar mund të mos jetë gjithmonë një prioritet, ka një njohje në rritje të rëndësisë së tij në mbarë botën. Duke vendosur synime specifike kursimi dhe duke krijuar një plan për arritjen e tyre, të rinjtë mund të ndërtojnë një themel të fortë financiar dhe të arrijnë qëllimet e tyre financiare afatgjata.

#### 1. Rëndësia e menaxhimit të parave:

- Menaxhimi i parave është i rëndësishëm për arritjen e stabilitetit dhe sigurisë financiare. Ai përfshin krijimin dhe mbajtjen e një buxheti, kursimin për emergjencat dhe qëllimet e ardhshme dhe shmangien e borxhit.
- Zakonet e mira të menaxhimit të parave gjithashtu mund t'ju ndihmojnë të shmangni stresin financiar dhe të përmirësoni cilësinë e përgjithshme të jetës.

#### 2. Roli dhe rëndësia e menaxhimit të financave personale:

- Menaxhimi i financave personale është një nëngrup i menaxhimit të parave që fokusohet në qëllimet dhe nevojat individuale financiare. Ai përfshin krijimin dhe respektimin e një plani financiar të personalizuar që merr parasysh të ardhurat, shpenzimet dhe qëllimet tuaja të ardhshme.
- Menaxhimi i mirë i financave personale mund t'ju ndihmojë të arrini qëllimet tuaja financiare, të tilla si kursimi për një paradhënie në një shtëpi ose shlyerje e borxhit.

#### 3. Ndikimi i sjelljes financiare individuale, jo vetëm për të ardhmen financiare, por edhe për mjedisin dhe shoqërinë:

- Sjellja financiare individuale mund të ketë një ndikim të madh në rezultatet financiare personale, si dhe në çështje më të gjera ekonomike dhe sociale. Për shembull, vendimet e dobëta financiare, të tilla si marrja e shumë borxheve ose mos kursimi për pension, mund të çojnë në paqëndrueshmëri financiare dhe stres.
- Për më tepër, vendimet financiare individuale mund të kenë një ndikim në mjedis dhe shoqëri, të tilla si zgjedhja për të investuar në kompani të qëndrueshme për mjedisin ose dhurimi për kauza bamirësie.

#### 4. Qëndrimi i të rinjve në lidhje me nevojat për edukim financiar:

- Shumë të rinj e kuptojnë rëndësinë e edukimit financiar dhe nevojën për edukim më të mirë financiar.
- Megjithatë, edukimi financiar nuk është gjithmonë një prioritet në shkolla ose në familje dhe shumë të rinj mund të mos kenë akses në burimet dhe informacionin që u nevojiten për të marrë vendime të informuara financiare.

#### 5. Dëshirat/qëllimet që përpiqeni të arrini përmes kursimeve:

- Kursimi i parave mund t'ju ndihmojë të arrini një sërë qëllimesh financiare, të tilla si blerja e një makine, pagesa e kolegjit ose kursimi për daljen në pension.

Është e rëndësishme të vendosim synime specifike kursimi dhe të krijojmë një plan për t'i arritur ato, si p.sh. caktimi i një sasive të caktuar parash çdo muaj ose investimi në një llogari kursimi me rendiment të lartë.

**Duke filluar për të kursyer herët dhe shpesh, mund të ndërtojmë një themel të fortë financiar dhe të arrijmë qëllimet tona financiare afatgjata.**





**Omer Honsic**, Shkolla e mesme e Mjekësisë, viti i III-të , Pejë,

Të jesh i arsimuar financiarisht do të thotë të kesh aftësi për të menaxhuar paratë personale. Të krijosh dhe zhvillosh aftësi, të cilat do të reflektohen në përparimin tonë të mëtejshëm në aspektet e jetës. Të udhëhiqemi nga qëllimet e vendosura, sepse vetëm kështu do të kemi sukses. Përveç përfitimeve ekonomike, paraja ofron edhe vlerë sociale dhe kulturore; na lejon të marrim pjesë në aktivitete të kohës së lirë dhe ngjarje kulturore, si koncerte, filma dhe muzeume. Paratë mund të përdoren gjithashtu për të mbështetur kauza bamirësie dhe për të bërë donacione për organizatat që punojnë për një shoqëri më të mirë.

Pavarësisht përparësive të shumta, paraja mund të krijoj sjellje të papjekura. Kjo mund të çojë në lakmi, korrupsion dhe rrënim. Të dish të matësh "besueshmërinë" e parasë, sepse shpeshherë mund të jetë një shërbëtor i mirë, por jo nëse është në dorën e zotërisë së gabuar.

Arsyeja për këtë është lakmia, sepse fare lehtë mund të ketë pasoja negative në të gjithë rrjedhën e periudhës së ardhshme, edhe në rrugë të gjata. Pakujdesia dhe murrja e tepruar, mendimi i rrënjësor se kemi ndikim të madh për shkak të pasurisë së bollshme, krijon një imazh mizor dhe arrogant.

Ajo që aplikoj shpesh në çdo aspekt është se nuk më interesojnë komentet e të tjerëve, dhe vendosjen e barrierave psikologjike. E izoloj veten nga të gjitha ato argumente të panevojshme dhe të pakuptimta, sepse këmbëngulja i kapërcen gjithmonë të gjitha pengesat dhe vështirësitë. Suksesi arrihet me punë dhe këmbëngulje të vazhdueshme. Darka më e ëmbël është ajo që fitohet me mund. Lumturia arrihet nga ajo që na përmbush më shumë. Zotërimi i burimeve materiale fshihet në dituri.

Është një avantazh i madh i atyre që dinë të vlerësojnë edhe shumat e vogla, sepse ato nuk do të plotësohen as me një shumë më të madhe, është çështje besimesh, fjalësh dhe zakonesh nga njëra anë dhe matematikë e pastër nga ana tjetër. Gjithçka vjen nga mendja jonë.

Ne bëhemi ajo që i kushtojmë rëndësi shumicën e kohës. Kërkojmë përkushtim, investim të mirë, për të mos u përfshirë në rreziqe që mund të çojnë në falimentim. Të tregojmë aftësi dhe bujari duke u shpërndarë në mënyrë normale në të gjitha drejtimet dhe të mbajmë nën kontroll që të investojmë në atë që shohim prosperitet. Përqendrimi duhet të jetë veçanërisht brenda profesionit, por jo për të bërë diçka vetëm për të kapur bilancin e peshuar të parave, por për ta dashur dhe me shpirt. Më e rëndësishmja është që çdo gjë që bëjmë, ta bëjmë me dashuri, gjithçka tjetër vjen natyrshëm.

Problemet më së shpeshti lindin kur sistemi i qëndrimeve është i vendosur keq, kështu që dëshirat i kapërcejnë nevojat. Një pakujdesi e tillë është shumë e zakonshme në sjelljen njerëzore, kështu që shumë individë (e madje edhe ne vetë) kënaqemi me hijeshitë e konsumit impulsiv, përpara se të plotësojmë shpenzimet elementare të jetesës.

Ndonjëherë xhelozia është gjithashtu një faktor që të çon në situata afatgjata dhe të pakapërcyeshme. Konkurrenca, për të përqaftuar sa më shumë, për të pasur asete më të mira apo nevoja për t'u provuar të tjerëve, na vendos në pozitën e skllëvërve .

Në botën e sotme, kur procesi i globalizimit dhe inflacionit është jashtëzakonisht i pranishëm në nivele të paarrtshme, duhet të jetë i pranishëm kontributi, kjo do të thotë se në një farë mënyre ne duhet të sjellim rezultate pozitive, si për veten tonë ashtu edhe për rendin ekonomik. Prandaj, efikasiteti i ndërmjetësisë dhe qarkullimi që ne ofrojmë janë brenda fushës së aktiviteteve të përmirësimit ekonomik. Nuk është e rëndësishme të lartësosh veten, por të përdorësh dhe t'u transferosh të tjerëve atë që mund t'u ndihmojë atyre.

Organizimi dhe njohuria për kontrollin e duhur duhet të jetë prioritet për të reduktuar në minimum konsumin ditor, mujor, madje edhe vjetor.

Ky nuk është një zakon që lind brenda natës, por fitohet gradualisht.

Aftësia e planifikimit dhe investimi i zgjuar në një biznes që do të jetë fitimprurës është, për mendimin tim, një nga elementët thelbësorë për pasurimin e përhershëm. Shikoni të gjitha pengesat e mundshme, planifikoni procesin e biznesit, krijoni një mjedis të zgjuar dhe të talentuar, tërheqni konkurrencën, si një arsye për avancim edhe më të madh në karrierë...duke mos dëmtuar askënd. Buxheti, si një element i pandashëm, luan rolin më të rëndësishëm në veprimin e qëllimshëm për planifikimin dhe "parashikimin" e burimeve financiare.

Financat personale nuk lidhen vetëm me momentin, por çdo procedurë e kryer i përket së ardhmes.

Sjellja financiare e një individi mund të ketë një ndikim të rëndësishëm jo vetëm në të ardhmen e tij.

Mënyra se si shpenzojmë, kursejmë dhe investojmë mund të ketë efekte pozitive dhe negative në botën përreth nesh. Një nga mënyrat në të cilat unë mund të ndikoj në mjedisin si person është duke përdorur të prodhuara nga materiale miqësore me mjedisin.

Një mënyrë tjetër, e cila do të ishte një metodë e vërtetuar drejt një arritjeve, është zgjedhja e investimit. Kur investojmë në kompani që kanë prioritet qëndrueshmërinë dhe përgjegjësinë mjedisore, ne mund të ndihmojmë në mbështetjen e zhvillimit të këtyre praktikave.

Edukimi është një aspekt thelbësor i jetës moderne dhe nevoja për të është bërë edhe më evidente vitet e fundit.

Të rinjtë kanë nevojë veçanërisht për edukimin në drejtim të menaxhimit të burimeve financiare, në mënyrë që të marrin vendime të përgjegjshme dhe të informuara për lëvizjet e tyre të ardhshme, për të hedhur themelet për një të nesërme më të mirë.

Përparësi duhet dhënë nevojave të menjëhershme dhe të pashmangshme, jo asaj që mund të sigurojë lumturi afatshkurtër.

Në këtë mënyrë, ne e gjejmë qëllimin tonë dhe pikën e ekzistencës në një luftë të vazhdueshme, madje edhe duke shkatërruar marrëdhëniet familjare, në garën për zgjerim dhe grumbullim.

Përparësi duhet t'u jepet nevojave të menjëhershme dhe të pashmangshme, jo asaj që mund të sigurojë lumturi afatshkurtër. Pasi një mundësi humbet, ajo mund të mos ndodhë më kurrë.

Veprimi interaktiv dhe i përbashkët mund të ndërjegjësojë të gjithë, veçanërisht ata që duan, por nuk dinë nga t'ia nisin. Do të bëja një vepër të mirë si për veten time ashtu edhe për të tjerët, nëse do të zgjoja ndërjegjësimin e atyre që besojnë fort se bashkëvarësia mes parave dhe njerëzve nuk krijohet menjëherë... Përvoja dhe gabimet e shpeshta janë një element, i cili jo vetëm frymëzon këmbëngulje edhe më të madhe për t'u bërë i famshëm, por, mund të them me siguri, gjëja më e rëndësishme që ofron është përpjekja për të mos u dorëzuar. Humbjet janë vetëm për të dobët, nuk lënë vend për fituesi, sepse plakemi shumë shpejt dhe bëhemi të mençur shumë vonë.

Do të tregoj një histori për një përrua të vogël që arrinte buzë shkretëtirës, i cili dëgjoji një zë që i thoshte të lëvizte lirshëm përpara. Por përroi i vogël kishte frikë nga e reja dhe e panjohura, kishte frikë dhe rezistencë ndaj ndryshimit, donte të kishte më shumë ujë në të, por në të njëjtën kohë nuk do të ndodhte asnjë ndryshim dinamik. Kështu, megjithatë, ai vendosi të shkonte. Në drejtim të shkretëtirës. Ishte shumë nxehtë dhe bëhej më e nxehtë çdo ditë. Përroi përfundimisht u tha, dhe pikat e vogla u mblodhën instinktivisht dhe u drejtuan drejt qiellit. Aty u bënë një re dhe kështu arritën në det. Ai filloi të merrte frymë me plot mushkëri dhe e kuptoi se ndonjëherë është e nevojshme të rrezikosh për të qetësuar shpirtin.

Të kujdesemi për atë që sjell dita e re, të mos dorëzohemi.

Pjesa e dytë e ekzistencës sonë fillon kur largohemi nga paragjykimet dhe opinionet e gabuara që kemi fituar gjatë pjesës së parë. Qëndrimi është se, nëse nuk e kthejmë vëmendjen edhe në detajin më të vogël në lidhje me karrierën dhe profesionin që do të merremi, është njësoj si një endacak që nuk di se ku shkon. Kështu bëhet njeriu atopik, i padurueshëm dhe nuk luan ndonjë pozicion të veçantë në të qenit i qëndrueshëm fizikisht, nëse nuk zhvillon imagjinatën mendore dhe nuk e vendos "Unë" tënde aty ku duhet.

Kam në plan që në vijim, gjatë përfundimit të studimeve universitare, të marr arsim joformal, lidhur me hapjen e një instituti i cili do të merret me kërkime laboratorike, në fushën e gjenetikës, si për mua ashtu edhe për vendin ku unë jetoj, një hap i madh drejt zhvillimit dhe ndërtimit të një sistemi shëndetësor më të mirë. Do të sillja investitorë të huaj dhe do të investoja për të mundësuar një lloj "ofensive" optimiste për çrregullimet gjenetike, që sot janë gjithnjë e më të përhapura. Do të mundem vetëm arrije këtë nëse e mbaj kontrollin mbi mbi financat brenda kufijve të shpenzimeve dhe kursimeve normale. Gjithmonë ka qenë ëndrra ime hapja e një qendre fitnesi, për të na mundësuar mua dhe të tjerëve ekuilibër të shëndetit fizik përmes ushtrimeve.

Udhëtimet janë një tjetër eksperiencë argëtuese, për të cilën do të lë mënjanë sasinë e nevojshme. Elementi i brendshëm, që më tërheq prej kohësh, për të hyrë në hijeshitë e pyjeve oqeanike dhe detare, thesaret e njohura arkeologjike dhe antike, mali, rajone, që nxjerrin ajër të pastër dhe të papërshkrueshëm.

Dua të ndihmoj të varfërit. Bamirësia është cilësia më humane por me ritmin dhe dinamikën e jetës filloi të humbiste gjithnjë e më shumë. Pse të mos e bëj dikë të paktën pak të lumtur?

Por gjëja më e rëndësishme është ruajtja e familjes. Asnjë veprim i vetëm nuk duhet t'i shkatërrojë marrëdhëniet me prindërit, vëllezërit dhe motrat.

Le të jemi më të mirët në çdo gjë që jemi. Le t'i përdorim paratë si burim force, jo si analogji për keqdashjen.

***Le të mbjellim rrënjë të mira, që të korrin fruta me lëng!***





**BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**  
**CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA**  
**CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO**

**Banka Qendrore e Republikës së Kosovës**  
**Rr. Garibaldi nr.33, Prishtinë, Kosovë**  
**+383 38 222 055**  
**[www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)**